Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VII
Sesioni Vjeshtor
Komisioni për Buxhet dhe Trasnfere
Mbledhja nr. 34/20
Prishtinë, më 09.12.2020, ora 10:00
Salla C-203, Ndërtesa e Kuvendit

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhjen morën pjesë deputetët: Hekuran Murati, Mimoza Kusari Lila, Yllza Hoti, Shkelzen Hajdini, Fatmir Rexhepi, Fikrim Damka dhe Veton Berisha.

Munguan deputetët: Verica Ceranic, Gazmend Abrashi, Bedri Hamza dhe Kujtim Gashi.

Pjesëmarrës të ftuar: Ruzhdi Morina – Kryesues i Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), Ymer Ymeri – anëtari i Bordit të FKPK-së, Adrian Zalli – Drejtor Menaxhues në FKPK, Shaip Havolli – Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Bedri Mecini – Drejtor i Administratës në AKK, Sali Bashota – Kryetar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), Petrit Musolli - anëtar i Bordit të RTK-së, Ngadhnjim Kastrati – Drejtor i Përgjithshëm në RTK, Adelina Valla Hyseni - Udhëheqëse e Financave në RTK.

Pjesëmarrës tjerë: Valdet Hadri - Zyrtar të Lartë për Analiza Buxhetore dhe Financiare në Kuvendin e Kosovës, Getoar Mjeku - Asistent i Kryetarit të Komisionit, Ismail Shabani – Gazetar nga Kosovapress, Aulona Sylaj – Gazetare nga Ekonomia online, Valmira Saraçi – Gazetare nga RTK, Ardita Zeqiri – Gazetare nga Birn.

Nga stafi mbështetës i Administratës së Kuvendit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Hekuran Murati – Kryetar (tutje kryetari).

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Votimi i Raporti vjetor të punës së Komisionit për Ndihmë Shtetërore dhe Raportit të Ndihmës Shtetërore për vitin 2019;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-049 për deminim humanitar;**
4. **Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e**

taksave vjetore për vitin 2021;

5. **Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit vitin 2019;**
6. **Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2019;**
7. **Votimi në parim i Projektligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021;**
8. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendi të ditës**

Kryetari: Konstatoi se Komisioni unanimisht miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. **Votimi i Raporti vjetor të punës së Komisionit për Ndihmë Shtetërore dhe Raportit të Ndihmës Shtetërore për vitin 2019**

Kryetari: Në mbledhjen e fundit të komisionit, është shqyrtuar Raporti vjetor i punës së Komisionit për Ndihmë Shtetërore dhe Raportit të Ndihmës Shtetërore për vitin 2019, diskutimet kanë përfunduar dhe në mungesë të kuorumit kjo pikë nuk është votuar dhe është radhitur për votim këtë mbledhje.

Pas përfundimit të diskutimeve, dhe në bazë të rezultatit votimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, për Kuvendin nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratoi Raportin vjetor të punës së Komisionit për Ndihmë Shtetërore si dhe Raportin e Ndihmës Shtetërore për vitin 2019.

3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-049 për deminim humanitar**

Kryetari: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-049 për deminim humanitar është shqyrtuar nga komisioni funksional për çështje të sigurisë dhe mbrojtjes, i cili komisioni ka dërguar raportin pa amendamente. Në bazë të Deklaratës së Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave, por edhe deklaratës së ministrisë inicuese të projektligjit (ministrisë së mbrojtjes), projektligji nuk përmban kosto shtesë buxhetore dhe kostoja buxhetore për zbatimin e ligjit është pjesë e buxhetit të Kosovës 2020 dhe KASH-it 2021-2023.

Pas përfundimit të diskutimeve, dhe në bazë të rezultatit votimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, për Komisionin funksional nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-049 për deminim humanitar, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

4. **Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2021**

Kryetari: Në bazë të nenit 4, paragrafi 17 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116, aktivitetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (Fondi), financohen përmes pagesave të arsyeshme të bazuara në shpenzimet e llogarive individuale. Kuvendi i Kosovës cakton taksën investive dhe operacionale në bazë të kërkesës së Fondit për çdo vit kalendarik, e cila kërkesë duhet të jetë e specifikuar me të gjitha shpenzimet e përllogaritura për periudhën, për të cilën paraqitet kërkesa.
Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) ka dërguar në Kuvend kërkesën për miratimin e taskës investive dhe operacionale për vitin 2019 dhe Komisioni për Buxhet dhe Transfere është ngarkuar që të shqyrtojë këtë kërkesë dhe të paraqes raportin me rekomandime në Kuvend. Lidhur me këtë pikë kemi ftuar Kryesuesin e Bordit Drejtuese FKPK-së, zotin Ruzhdi Morina, nga e cili kërkojmë që të prezantojë dhe arsyetojë Kërkesën për miratimin e taksave vjetore për vitin 2021.

Ruzhdi Morina: FKPK siç shihet në procedura dhe legjislacioni në fuqi, kemi kërkuar nga Kuvendit që të miratohen nga Kuvendi tarifat për vitin 2021. Jemi munduar të jemi shumë të arsyeshëm në propozimet që i kemi, ne nuk kemi paraparë ndonjë ndryshim nga viti paraprak në taksën e skemës në fjalë. Sa i përket taksës investive kemi paraparë një ulje të vogël 0.3%, ndërsa 0.82% e mjeteve në këmbim dhe atë rreth 250 mijë euro më e ulët se në vitin paraprak.

Adrian Zalli: Ne kemi bërë disa vlerësime se ku jemi me asete dhe cilat janë pritshmëritë për vitin 2021. Menaxhimi i vitit pritet të filloj me një bazë prej 2 miliard e 700 milionë euro, gjatë 2021 presim arkëtime prej 180 milionë, tërheqje 87 milionë, shuma pritet të tërhiqe në emër të 10%. Nëse mirret mesatarja kemi mendu që do jetë 2 miliard e 31 milionë mjete nën menaxhim dhe taksa investuese është bazuar mbi këtë shifër. Nëse e aplikojmë 0.32% mbi mjetet mesatare, i bie 6.5 milionë për menaxhimin e mjeteve, që është rreth 250 mijë euro më e ulët se vitin e kaluar. Sa i përket taksës operacionale, kemi propozuar ta mbajmë të njëjtë.

Kryetari: Shoh që siç e përshkruat, keni shkurtuar numrin e aset menaxhereve që ka qenë edhe kërkesa jonë si komision me rastin e shqyrtimit të tarifave për vitin 2020. Po ashtu shoh se edhe në buxhetin operacional janë reflektuar kërkesat e komisionit. Sa i përket tërheqjes së 10%, a keni bërë ndonjë analizë sa do mund të tërhiqen si shifër reale?

Adrian Zalli: Kalkulimet ndryshojnë, do kompensohen në fund sepse mund të kemi një shumë më të madhe dhe njerëzit kanë pritshmëri që do i marrin pas viti 2023.

Ruzhdi Morina: Politika jonë është në linjë me komisionin dhe në parametra real mund të jetë më i lartë se aq por nuk guxojmë të flasim me vlera strikte. Në politikë investive mendojmë të jemi sa më të lirë.

Shkelzen Hajdini: Unë do të votoj për këtë kërkesë dhe ju falënderoj që keni marrë në konsideratë kërkesat tona dhe janë reflektuar në buxhetin e juaj për vitin e ardhshëm. Taksat si ajo operacionale dhe investive mund të ketë një rënie të lehët dhe të menaxhueshme.

Mimoza Kusari Lila: Në bazë të ligjit që ka kaluar për rimëkëmbjen ekonomike, pas 6 muajve pritet të që ministria e financave në konsultim me ju të nxjerrë aktet përkatëse për metodologjinë e kthimit të mjeteve që do të tërhiqen prej 10% për kontribuuesit deri në shumën 9.999 euro, dua të ju pyes a ka filluar diçka me u bisedue në lidhje me këtë temë? A jeni kontaktuar nga ministria e financave?

Ruzhdi Morina: Që të jemi të hapur, dje në një takimi që kemi pasur me Kryeministrin dhe Ministren e Financave është hapë kjo temë dhe besoj që tash do koordinohen veprimet në vijim.

Yllza Hoti: Te pjesa e qirasë së zyrës, në vitin paraprak ka qenë më e lartë, ndërsa tani është një shumë më e vogël, ka pas ndonjë ndryshim apo është ndonjë gabim teknik?

Adrian Zalli: Jo nuk është gabim, por qiraja ka të bëjë me shtimin e një zyre shtesë që ndërlidhet me operacionet e 10% të trustit sepse kemi shtuar punëtor shtesë për kohë të caktuar.

Kryetari: Në vitin 2020, kërkesa për qira ka qenë 54 mijë, ndërsa tani është 11 mijë, pra 900 euro në muaj apo?

Adrian Zalli: Ne kemi dy projekte që ndikojnë në pjesën e qirasë, e para një projekt për zyrtar të IT-së dhe pastaj pjesa e 10%. Arsyeja pse ndryshon shifra është se një pjesë e qerasë është reflektuara në zërin buxhetor "zhvlerësimi dhe amortizimi", pra ka pas paraqitje të shumës sipas rregullit të kontabilitetit, përndryshe qiraja është e njëjtë, përveç shtesës që përmenda për zyrë e shtuar.

Pas përfundimit të diskutimeve, dhe në bazë të rezultatit votimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, për Kuvendin, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratoi të miratojë Kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për caktimin e taksës investive prej 0,32% dhe taksës operacionale prej 0,065%, për vitin 2020.

5. **Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2019**

Kryetari: Në bazë të nenit 5, paragrafi 1.16, dhe nenit 12 të Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Agjencia i raporton Kuvendit një herë në vit. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka dërguar raportin vjetor në Kuvend dhe Komisioni për Buxhet dhe Transfere është ngarkuar që të shqyrtojë Raportin financiar të këtij institucioni, dhe të paraqes raportin me rekomandime në Kuvend.
Lidhur me këtë pikë kemi ftuar Drejtorin e Agjencisë zotin Shaip Havolli, nga i cili kërkojmë që të prezantojë dhe arsyetojë Raportin në fjalë.

Shaip Havolli: AKK si organizatë buxhetore ka kryer raportimin për vitin 2019. Buxheti final 535.402 euro, ndërsa 93% e buxhetit në total është shpenzuar. Ka pas rritje në paga e mëditje për shkak që janë shtuar shtatë pozita. Investime kapitale nuk ka pasur. Më pas prezantoi buxhetin e miratuara dhe shpenzuar sipas kategorive ekonomike.

Mimoza Kusari Lila: Në raport me funksionalizimin në periudhën e pandemisë, si rrjedhojë e rrethanave, paraqitja e pasurisë është bërë online, dhe si rezultat janë paraqitur një mori komplikimesh dhe pengesash në plotësimin e formularëve. A ka pas problem me evidentim në siste apo ka pasur ndonjë arsye tjetër për këto probleme të shfaqura? A është rregulluar sistemi apo ka akoma komplikime të tilla?

Shaip Havolli: Për shkak pandemisë ka qenë një problem në plotësimin e formularëve online të deklarimit të pasurisë. sepse ne ju kemi thënë që ti paraqesin të dhënat të skanuara në zyrtar dhe sistemi ynë ka marrë një numër të madh të dërgimeve dhe si pasojë ka rënë sistemi, pastaj i kanë dërguar në adresa tjera dhe kemi filluar me i paraqitë në listë, por paraprakisht për shkak të korrektësisë i kemi thirrur zyrtarët për konfirmime dhe ka pasur vonesa. Ne kemi një sistem shumë të vjetër softuerik. Në këtë drejtim UNDP është duke na përkrahur në krijimin e sistemit të ri online dhe jemi në fazën finale krijimit të këtij sistemi.

Mimoza Kusari Lila: Problemi mendoj që ka qenë më shumë subjektiv sepse dorëzuesit kanë pranuar email konfirmimi. Janë të mirëseardhura donacionet dhe ndihma, por nga i gjithë buxheti i shtetit, a nuk ka pasur mundësi të gjinden fondet për të azhurnuar serverin ose kalimin në sistem online? A nuk iu janë mbështetur institucionet me buxhet për këtë qëllim?

Shaip Havolli: Ne kemi bërë kërkesa buxhetore edhe më herët që së paku në dy tre vitet e ardhshme të financohet sistemi por nuk ka pas interesim për investime kapitale, kështu që do bashkëpunojmë më ambasadën amerikane dhe besojmë që kjo do të realizohet. Por ne kemi pas problem edhe me kalimin e dy ligjeve. Problem tjetër ka qenë aprovimi i shtatë pozitave për divizionin për sinjalizues dhe atë për konflikt interesi. Meqë ligji për të zyrtaret publik ligji ka shkuar në kushtetuese, punësimi i katër pozitave nuk ka ndodhur dhe pastaj është largu buxheti edhe ato pozita. Ne kërkojmë që të na kthehen ato katër pozita për ta përmbushur projektin tonë.

Fatmir Rexhepi: E dëgjuam prezantimin e raportit financiar nga ana juaj dhe e vlerësoj se ishte në suaza të planifikimit. Do doja të dija nëse keni pas auditim të brendshëm ose të jashtëm? Pjesa e dytë për riorganizim dhe strategjinë e punës, modalitet e reja të gjitha këto japin një pasqyrë që ky agjension në formën e re do të ketë mundësinë e një angazhimi më të madh në të ardhmen.

Mimoza Kusari Lila: Absolutisht z. Havolli jap mbështetje të plotë për agjension tuaj, por do donim nga ana juaj të kishim një seancë informuese në raport me konfliktin e interesit të deputetëve në disa sfera. Jo pak deputetë janë biznesmen dhe jo pak nga ta po i shfrytëzojnë pozitat me ndikuar në ligje që drejtpërdrejt kanë përfitime bizneset a tyre. Unë mendoj që Agjencia kundër korrupsionit, përveç pranimit të informacionit edhe detyrën pro-aktive me dhanë një deklarim. Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve të juaja duhet të shkoj në drejtim të rrethanave që të funksionojë rendi dhe ligji.

Shkelzen Hajdini: Ju keni një buxhet të vogël dhe shpenzimi i këtij buxheti ka qenë i kënaqshëm. Megjithatë buxheti nuk është shpenzuar në nivelet e kërkuara. Do të isha ndalë tek mallrat dhe shërbimet, shoh që është shpenzuar buxheti 75% , ju inkurajoj që të bëni planifikim të mirëfilltë, përveç katër pozitave, unë ju inkurajoj të planifikoni buxheti që lidhet me sistemin e mirëmbajtjes të softuerit që përmendet se jeni duke e krijuar. Kjo do të kushtoj kosto shtesë dhe mbase duhet të planifikoni për shpenzime të trajnimit sepse për ne është shumë më rëndësi ti shohim këto suksese nga ana juaj.

Yllza Hoti: Si deputete e re më ka rënë për herë të parë të bëjë deklarimin e pasurisë, nëse shohim formularët për aplikim në ueb-in tuaj, shihet se nuk ka konsistencë në të dhëna që duhet deklaruar, dikush e ka bërë në paga mujore dikush në vjetore, mbase do duhet të ishte një guidë apo udhëzues të paraqitjes së të dhënave të pasurisë. Sa i përket raportit financiar, tek shpenzimet për kontraktuesit tjerë, shihet se ka qenë një rritje e buxhetit në planifikim krahasuar me vitin paraprak, ndërsa shpenzimi për këtë kategori është i ulët, përse keni pasur një dallim të tillë në mes buxhetit të planifikuar dhe ekzekutuar për këtë kategori?

Shaip Havolli: Sa i përket raportit të auditorit, ne brenda vitit kemi dy auditime nga ZKA, ne nuk kemi marrë ndonjë gjetje me rëndësi të madhe. Sa i përket konfliktit të interesit, ne kemi bërë një manual që

dhe në bazë të ligjit, secili institucion është i obliguara të caktojë personin përgjegjës që kujdeset për konfliktin e interesit dhe të miratojë rregulla të brendshme për këtë qëllim që janë në harmoni me ligjin dhe personi në fjalë është personi i parë i kontaktit për konflikt të mundshëm të interesit. Në rast se kërkohet ndihma shtesë, ne si agjenci pastaj veprojmë. Sa i përket deklarimit të pasurisë dhe patjetër që ka a dilema, por me ligjin e ri mbi deklarimin e pasurisë që jemi duke punues, dhe në ndërtimin e platformës së re online, nuk do të lejon të kalosh në faqen tjetër pa u plotësuar i gjithë sistemi. Sa i përket çështjes së shpenzimeve në mallra e shërbime, nganjëherë edhe në planifikim tentojmë në kursim të buxhetit të Kosovës sepse kemi edhe donacione.

Bedri Mecini: Tek shpenzimet kontraktuese, kemi planifikuar buxhet më shumë pasi që kemi menduar se do të dal një kosto më e madhe lidhur me investimin që kemi bërë në sistemin e arkivimit dhe paisjeve tjera, pastaj sistemin kundër zjarrit jashtë objektit, por që kemi arritur që këtë projekt ta realizojmë me shpenzime më të vogla dhe mjetet e planifikuar më të mëdha, kanë shkuar në suficit.

Veton Berisha: Nga numri i të punësuarve në institucion tuaj, kam vërejtur se përbërja etnike tek ju është minimale. Ju besojë se e keni parasysh ligjin për shërbimin civil i cili kërkon punësimin e të paktën 10% të komuniteteve jo shumicës. Prandaj, kërkojë që çështjen e punësimeve nga komunitetet jo shumicë ta merrni parasysh në punësimet e reja që do ti keni, pasi që është një obligim ligjor.

Shaip Havolli: Ne kemi pas konkurse të hapura dhe për profesionistët Agjencia jonë është e hapur, pa dallime etnike dhe dallime tjera. Ne me riorganizim të Agjencisë do kemi nevojë edhe për më shumë pozita dhe padyshim do shohim që të përfshihen edhe komunitete tjera.

Kryetari: Dua vetëm të jap disa vërejtje, procesi i deklarimit të pasurës edhe nuk është aq efikas dhe ka shumë keqinformim edhe tek zyrtarët. P.sh. të deklarohet paga e pritur, kur ligji kërkon të ardhurat e kaluar. Si Agjenci më shpesh merreni me formalitete sesa me substancë, në ueb faqe, shumica e rasteve kanë të bëjnë për ndonjë asamblist që ka pas ndonjë biznes individual e që nuk janë më në detyrë apo kanë përfunduar mandatin. Le të mos humbet fokusi i agjencisë në gjëra minore por në problemet e mëdha.

Shaip Havolli: Në raportin e pjesës së dytë te material, është e vërtetë që ne merremi me çështje si thatë ju por ne veprojmë në bazë të informative që kemi. Mirëpo ka edhe raste të mëdha që ne nuk i kemi bërë publike sepse nuk janë bërë publike, por ato nuk janë publike por janë në prokurori. Pikërisht për këtë ne kemi kërkuar që ligji të ndryshohet që ne të merremi me substancën.

Pas përfundimit të diskutimeve, dhe në bazë të rezultatit votimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, për Kuvendin, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratoi Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2019.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2019

Kryetari: Në bazë të nenit 30, paragrafi 8 dhe 9 të Ligji nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës i raporton Kuvendit në baza vjetore. Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) ka dërguar raportin vjetor në Kuvend dhe Komisioni për Buxhet dhe Transfere është ngarkuar që të shqyrtojë Raportin financiar të këtij institucioni dhe të paraqes raportin me rekomandime në Kuvend.

Lidhur me këtë pikë kemi ftuar Kryetarin e Bordit të RTK-së, z. Sali Bashota , nga e cila kërkojmë që të prezantojë dhe arsyetojë Raportin në fjalë.

Salih Bashota: Në çdo raport është e rëndësishme që të hyrat të menaxhohen sipas planifikimit buxhetor dhe projeksioneve dhe rastin konkret për RTK-në ka shkuar kësisoj. Ky raport reflekton për periudhën e viti 2019, kur RTK ka qenë me 7 anëtar në bord, ndërkaq menaxhmenti nuk ka qenë i plotë. Evidentimi dhe specifikimi i këtij raporti ndërlidhet me shpenzimet që ndahen sipas raporti të kërkuar. Po ashtu i kemi cekur edhe të hyrat dhe donacionet që i kemi pas atë dhe të dhënat janë për çdo shpenzim që ka ndodhur.

Fatmir Rexhepi: Nga ky raport shohim se puna e RTK-së ka paraqitur pengesat evidente, në mungesë të bordit. Ajo që u cek këtu tregon për transparencën dhe nuk kemi çfarë të shtojmë përveç se shpresojmë që ti ndjekin rekomandimet e ZKA-së.

Veton Berisha: Edhe unë e mbështes raportin dhe transparencën në paraqitjen e aktiviteteve dhe të shpenzimeve të institucionit.. Unë dua të përmend faktin se në RTK për disa vite ishim të përfaqësuar nga komuniteti rom, pastaj është bërë një emision për komunitetin egjiptian që punuar me një situatë të paqëndrueshme për ne. Unë shpresoj që në një të ardhme të afërt të bëhej një emision i posaçëm për komunitetin tonë, që do ta ketë edhe redaktuarën e vet.

Shkelzen Hajdini: Unë do të fokusohem tek raporti financiar, si ka mundësi që buxheti të jetë i ekzekutuar 99.6% dhe përputhje të plotë me planifikimin. Po ashtu në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të ketë shpenzime 101%. Siç e kemi thënë edhe më herët, të hyrat kryesore të RTK-së vazhdojnë të jenë nga buxheti i Kosovës dhe me një përqindje të vogël si të hyra nga marketingu. Kërkoj nga ju ti shikoni planifikimet tuaja strategjike, për rritjen e të hyrave vetanake dhe që të qëndroni me vetëfinancim.

Kryetari: Unë nuk e di si vlerësoni si raport të mirë zoti Bashota, kur unë shoh se këtu ka disa shpenzime, si për shembull, filma dhe top shop 115,000 euro, filma dokumentar 77,00 euro, gjyshet milionere 78,000 euro, e shumë programe tjera si p.sh. drejtësia në Kosovë që këtë vit që është ofruar falas, ju e keni shkruar si shpenzim. Pastaj, pjesa e radios 52,000 euro, shpenzime në udhëtime zyrtare 100,000 euro, kompjuter 220,000 euro. Flasim për një staf me 900 persona të punësuar në RTK, dhe me një staf kaq të madh, në anën tjetër blerje kaq të madhe të programeve nga jashtë. Ka paga që ipen mbi 1,000 euro dhe një TV publik me borxhe te akumuluara dhe raste në gjykata për kontrata të nënshkruara pa bazë. Në një bazë si kjo nuk e di si mund të quhet raport i mirë dhe mendoj që nuk duhet të rekomandohet ky raport për votim.

Ngadhnjim Kastrati: Unë si drejtor i përgjithshëm në gjysmën viti kam marrë mandatin. Këto shpenzime që i përmendet zoti kryetar, kanë qenë të planifikuara dhe janë votuar ashtu. Jemi munduar që në vitin në vazhdim, aty ka pasur hapësirë të shkurtohen apo ndërpriten shpenzimet. Mendoj që ja kemi arritur që të menaxhohet mirë edhe në pjesën e borxheve. Nga muaji maj të gjitha kontratat janë ndërprerë. Në raportin vjetor për vitin 2020 do të pasqyrohen këto ndryshime në menaxhimin e buxhetit. Ne e dimë se ka hapësirë edhe për kritika, por ne jemi duke u munduar ta bëjmë më të mirën.

Salih Bashota: Skema programore e vitit 2020 ka shumë ndryshime nga viti i kaluar, ne kemi hequr disa emisione të pa rëndësishme dhe jemi përpjekur që kontratat të mos vazhdohen tutje. Në koordinim me bordin jemi munduar që të kalohet në një mire menaxhim të buxhetit. Televizioni i RTK-së punon në gjendje shumë të keqe dhe pa shpenzime kapitale. Nuk mund të funksionoj mirë një medium publik pa ndërtesë të vetën dhe askush nuk merr iniciativë që të mos mbetet e ngrirë si pozicion. Pra, na kemi nevojë për ndarje të buxhetit për shpenzime kapitale.

Kryetari: Nuk e di nëse ju po ankoheni për shumën e buxhetit, sepse si shumë ju paguheni më shumë se Kuvendi. Ne miratojmë për RTK-në si total, dhe i takon menaxhmentit të RTK-së se si të ndahet ai buxhet. Nga shpenzimet shihet se buxheti gjithnjë është rritur për shpenzimet e personeli për shkak të punësimeve të reja, dhe jo tek investimet kapitale. Ju vazhdoni të bleni emisione nga jashtë jo të prodhoni vet. Nëse ka një staf aq të madh dhe vazhdohet me u ble një numër i madh i programeve, atu del se nuk ka menaxhim të mirë.

Salih Bashota: Fjala për buxhet shtesë është për shpenzime kapitale dhe jo për rroga të personelit. Nuk mund ne ti largojmë punëtorët që janë aty që 20 vite. Ne kemi nevojë për mbështetje për çështjen e godinës. Ne kemi të kufizuar edhe në realizimin e të hyrave nga marketingu.

Kryetari: Ju mund ti shihni pasqyrat financiare, vazhdimisht ka pasur rritje të buxhetit nga shteti për RTK-në, ne nuk mund të përzihemi në mikro-menaxhimin, planifikimi, ndarjet buxhetore dhe shpenzimet janë përgjegjësi e institucionit, në këtë rast e RTK-së.

Ngadhnjim Kastrati: Te programet e jashtme, me ligj e kemi të obliguar që deri 15-20% të blihen emisione nga jashtë. Ne kur blejmë filma nuk mund ti bëjmë vet, jemi mundu që shumicën e emisioneve ti mbështesim me marketing.

Shkelzen Hajdini: Kërkoj të më kuptoni drejt, ne nuk kërkojmë që ju brenda vitit ta ktheni krejt projeksionin e të hyrave dhe shpenzimeve ndryshe dhe të vetëfinancoheni, por të bëhet me strategji në këtë drejtim që qon drejtë rritjes së vetëfinancimit të televizionit publik. Unë e çmoj tendencën tuaj për ekzekutim të borxheve, por ka hapësirë dhe duhet të bëhet më shumë në menaxhimin e buxhetit dhe rritjen e inkasimit të të hyrave vetanake. Duhet të përpiqeni që programet, konform ligjit, ti organizoni me stafin e brendshëm.

Kryetari: Konstatoi se nuk ka kuorum për vendimmarrje për këtë pikë dhe mbetet për votim në një mbledhje tjetër të komisionit.

7. **Votimi në parim i Projektligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021**

Kryetari: Konstatoi se nuk ka kuorum për vendimmarrje për këtë pikë dhe mbetet për votim në një mbledhje tjetër të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari Komisionit,

Hekuran Murati